

## Informacion mbi strehimin

Mjekët/mjeket kanë vendosur, që ju duhet të qëndroni këtu në spital.  
Urdhëresa emërtohet strehim.

### **Sa kohë vlen strehimi?**

Ai është vetëm atëherë i lejuar, nëse për shkak të një sëmundje psikike, ekziston një rrezik me pasoja të rënda për ju ose për persona të tjerë dhe nuk ka alternativa trajtimi. Strehimi duhet të përfundohet sapo këto kushte të mos ekzistojnë më.

### **Kush e kontrollon urdhëresën mjekësore?**

Strehimet kontrollohen nga një gjykatë. Një gjykatës/gjykatëse vjen rreth katër ditë pas fillimit të strehimit në spital. Ai/ajo vendos nëse ju lejoheni të largoheni nga spitali. Nëse vendoset që ju duhet të qëndroni ende, gjykata përcakton një datë të re për një kontroll tjetër. Por mjeku/mjekja mund ta përfundojnë edhe më parë strehimin.

### **Çfarë mund të bëjë mbrojtja e pacientit për ju?**

Ne ju informojmë mbi të drejtat tuaja dhe angazhohemi për çështjen tuaj. Ne ju përfaqësojmë juve te seancat gjyqësore. Ne jemi të pavarur nga spitali dhe jemi të detyruar të ruajmë konfidencialitetin. Puna jonë është falas për ju. Ju mund të na drejtoheni neve edhe pasi të keni dalë nga spitali.

### **Dëshironi të përfshini një person të besueshëm?**

Ju mund ti përmendni mjekëve/mjekeve një person të besuar, që ju mbështet.

### **Ju nuk jeni dakord me një trajtim të caktuar?**

Flisni me mjekët/mjeket tuaja, nëse ju refuzoni një trajtim. Ju mund të kërkoni edhe që më përpara të vendosë gjykata për zbatimin e trajtimit. Edhe masa të tjera, të cilat u morën kundër vullnetit tuaj mund të kontrollohen më pas nga një gjykatë.

### **Na kontaktoni nëse keni pyetje të tjera:**

